



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KESHILLI DREJTUES**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2017

**V E N D I M**

**Nr.26, datë 21.12.2017**

**Për**

**“Miratimin për këshillim publik të disa ndryshimeve në Rregulloren nr.43, datë 22.09.2016, “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit””**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Zj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Zj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Zj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj.Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 21.12.2017, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe Rregullore e Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare” miratuar me Vendimin Nr.7, datë 16.02.2017 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**“Miratimin për këshillim publik të disa ndryshimeve në Rregulloren nr.43, datë 22.09.2016, “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit””**

**BAZA LIGJORE:**

1. Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (**ligji nr. 9918**);
2. Rregullore Nr.43, datë 22.09.2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit” (**Rregullore**);
3. “Udhëzues për procedurat e këshillimit publik”, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 1183, datë 10.3.2010;

4. Urdhër Nr. 257, datë 12. 11. 2017, për “Ngritjen e grupit të punës për amendimin e Rregullores Nr.43, datë 22.09.2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit””.

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të paraqitur nga Grupi i Punës si më poshtë:

- Relacioni shpjegues mbi Projektaktin “Miratimin për këshillim publik të disa ndryshimeve në Rregulloren nr.43, datë 22.09.2016, “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit””;
- Dokumenti Rregullores me ndryshimet e propozuara për Këshillim Publik;
- Projektvendim i Këshillit Drejtues të AKEP i formatuar dhe arsyetuar;

si dhe:

- konsiderimi i shpjegimeve të dhëna nga relatori i çështjes dhe diskutimeve në mbledhje;
- fakteve të paraqitura dhe analizës së tyre referuar bazës ligjore të sipërcituar,

### **V Ë R E N:**

1. AKEP me VKD nr.2689, datë 22.09.2016, miratoi dokumentin “Rregullore për mënyrën e zbatimit të Portabilitetit të Numrit”. AKEP, në zbatim të ligjit nr. 9918/2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, akteve rregullatore të nxjerra në zbatim të këtij ligji si dhe duke marrë në konsideratë ndër të tjera problematikat e evidentuara në procesin e portimit, të lidhura kryesisht me numrat celularë, të tilla si:
  - a. Numri i madh i ankesave të pajtimtarëve, nga të dy kategoritë e tyre (parapagim dhe paspagim), në lidhje me përfitimin e shërbimit të portimit të numrit;
  - b. Shkresat e vazhdueshme nga vetë operatorët celularë, të cilët informojnë AKEP mbi praktika abuzive që shoqërojnë procesin e portimit të numrit për konkurrentët respektive;
  - c. Në përgjigjet negative për portimet evidentohet qartësisht keqpërdorimi i listës së arsyeve të parashikuara për refuzimin e kërkesës për bartje, ku ndër më kryesoret janë parashikimet e referuara në nenin 17, pika 5, nënparagrafi (dd, ee) të Rregullores Nr.43;
  - d. Komunikimin e vazhdueshëm shkresor me sipermarrësit në procesin e trajtimit të ankesave të paraqitura, nëpërmjet të cilave kërkohet ndërhyrje e AKEP për t’i mundësuar pajtimtarit një të drejtë të parashikuar qartësisht në Ligjin 9918, Rregulloren Nr.43 si dhe në kontratën e pajtimit me ofruesin e shërbimit. Arsyet e refuzimit nga ofruesit e shërbimit vihet re se kanë krijuar barriera të dukshme artificiale për pajtimtarët, duke ndikuar drejtëpërdrejt në demotivimin e pajtimtarëve për këtë shërbim si dhe uljen e efikasitetit të portabilitetit dhe

impaktit pozitiv të tij në zhvillimin e konkurrencës efektive në tregun e telefonisë celulare;

2. Bazuar në problematikat e evidentuara, AKEP çmon si të rëndësishme amendimin e Rregullores Nr.43, datë 22.09.2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”. Ndryshimet e propozuara synojnë lehtësimin dhe optimizimi i procesit të portimit të numrave, ndër të tjera nëpërmjet:
  - a. Përdorimit të Numrit Personal të Identifikimit i cili është numri unik personal që gjendet në Kartën e Identitetit, Pasaportën, Certifikatën e lindjes së cdo personi në RSH dhe që propozohet të jetë kriteri kryesor i identifikimit të pajtimtarit, si dhe mundëisë për saktësim të shpejtë dhe pa vonesë të këtij numri në bazën e të dhënave të operatorit dhënës;
  - b. Përdorimin e Numrit Personal të Identifikimit si kriteri kryesor për identifikimin e pajtimtarit dhe heqjen e kriterit të refuzimit për shkak të mospërthjes së emrit/mbiemrit të pajtimtarit në bazën e të dhënave të operatorit dhënës me kërkesën për portim (mjafton përputhshëmri e Numrit Personal);
  - c. Shtimit dhe saktësimin të disa përkufizimeve për numrat që mund të portohen;
  - d. Publikimin nga AKEP të raporteve periodike për portimet dhe performancën e secilit operator për portabilitetin, përfshirë afatet, refuzimet etj.;
  - e. Përfshirjen e përcaktimit në rregullore që koha e aktivizimit të numrit të portuar nuk duhet të jetë me gjatë se një 1 ditë pune nga koha e plotësimit të formularëve të portimit dhe rasteve përjashtimore nga ky afat;
  - f. Zgjatjen e orarit të pranimit të kërkesave për portim si dhe të kapacitetit ditor të pranimit dhe përgjigjeve të kërkesave për portim;
  - g. Përfshirjen në rregullore të mundësisë së AKEP që bazuar në raportet e CRDB si dhe në ankesat dhe mosmarrveshjet e pajtimtarëve për portimin e numrit (përfshirë statistikën për ankesat) të marrë masa proporcionale për shkeljet administrative të operatorëve për portabilitetin e numrit.
3. Bazuar në nenin 110 të ligjit nr. 9918, i ndryshuar dhe “Udhëzuesin për procedurat e këshillimit publik”, ky dokument do të nxirret për këshillim publik, me qëllim marrjen e mendimit të palëve të interesuara.

## **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Në mbështetje të procedurës së përcaktuar në nenin 114 dhe nenin 115 të Ligjit nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,

## **V E N D O S:**

1. Të miratojë nxjerrjen në këshillim publik të ndryshimeve të propozuara në Rregulloren nr. 43, datë 22.09.2016 “Për mënyrën e zbatimit të portabilitetit të numrit”, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ky Vendim dhe dokumenti i miratuar të publikohen në faqen e internetit të AKEP [www.akep.al](http://www.akep.al).
3. Periudha e këshillimit publik do të jetë 30 (tridhjetë) ditë nga data e publikimit të dokumentit në faqen zyrtare të AKEP në seksionin “Konsultime”.

Ky Vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R I**  
**ILIR ZELA**

**ANËTARË:**

1. **Alban KARAPICI**
2. **Anila DENAJ**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**

**KËSHILLIM PUBLIK I DISA NDRYSHIMEVE NË<sup>1</sup>:**

**RREGULLORE**

**Nr. 43 Datë 22.09.2016**

**PËR MËNYRËN E ZBATIMIT TË**

**“ PORTABILITETIT TË NUMRIT”**

**(Miratuar për këshillim publik me VKD nr.26, datë 21.12.2017)**

---

<sup>1</sup> Ndryshimet e propozuara në tekstin e Rregullores, janë theksuar me font ***bold, italic dhe underline***. Gjithashtu me footnotes jepen përcaktimet aktuale si dhe sqarime për ndryshimet/shtesat etj. Palët e interesuara mund të japin komente në lidhje me çdo ndryshim të propozuar në rregullore, duke dhënë referencat përkatëse.

# Kapitulli I

## Dispozita të përgjithshme

### Neni 1

#### Objekti

Objekti i rregullores është:

- a) përcaktimi i mënyrës së zbatimit të portabilitetit të numrit nga sipërmarrësit e rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike publike;
- b) përcaktimi i afateve kohore përkatëse për zbatimin e portabilitetit;

### Neni 2

#### Qëllimi

Qëllimi i rregullores është garantimi i zbatimit të protabilitetit të numrit nga të gjithë sipërmarrësit e rrjeteve publike telefonike dhe ose shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun, në përputhje me zgjidhjet teknike, mënyrën dhe afatet e përcaktuara në këtë rregullore.

### Neni 3

#### Baza ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 87, 88 të ligjit nr. 9918, datë 19.05. 2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr. 9918*), si dhe në mbështetje të nenit 8, shkronjën p) e këtij ligji.

### Neni 4

#### Përkufizime

Përveç sa parashikohet nga Ligji nr. 9918, për qëllime të kësaj Rregulloreje, Termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “AKEP” është Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, i cili mbikëqyr kuadrin rregullator, të përcaktuar nga ligji 9918, i ndryshuar, nga ligji për shërbimin postar, si dhe nga politikat e zhvillimit të fushës së komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.
2. “Baza e të dhënave referencë të centralizuar (CRDB)” është Baza Qendrore e të Dhënave Centralizuar për portabilitetin e numrit, e cila regjistron statusin e çdo mesazhi të transferuar gjatë procesit të bartjes së numrit, duke përfshirë informacionin e nevojshëm për rrugëzimin e thirrjeve për bartjen e numrave dhe duke përditësuar bazën e të dhënave lokale pasqyre të numrave të bartur.
3. “Baza e të dhënave lokale pasqyre (LBPS)” është një bazë aktive të dhënash e vendosur tek operatorët, që përmban të dhënat e nevojshme për rrugëzimin e thirrjeve tek numrat e bartur.

4. “Metoda All Call Query (ACQ)” është metodë rrugëzimi drejt numrave të bartur te çdo thirrje që përcakton se rrjeti origjinues, para vendosjes së çdo thirrje, përcakton rrjetin në të cilin numri i thirrur është i vendosur aktualisht duke kërkuar një pasqyrë lokale të bazës së të dhënave referencë të centralizuar.

5. “Operator” është një operator i rrjeteve disponueshme për publikun ose ofrues i shërbimeve telefonike të vlefshme për publikun, si dhe operator i sistemit bartës, transmetues i thirrjeve kombëtare ose ndërkombëtare;

6. “Operator Dhënës” është një operator i cili ofron shërbime telefonike të disponueshme për publikun në rrjetin e të cilit ishte vendosur numri i bartur para bartjes;

7. “Operator Marrës” është një operator i cili ofron shërbime telefonike të disponueshme për publikun në rrjetin e të cilit vendoset numri i bartur pas bartjes.

8. “Bartja e numrit” është transferimi i Numrit Kombëtar (NSN) në përputhje me Planin Kombëtar të Numeracionit, i cili mbetet i pandryshueshëm kur realizohet bartja midis dy operatorëve që mundësojnë ofrimin e rrjeteve/shërbimeve të komunikimeve të lëvizshme sikurse midis dy operatoreve që ofrojnë rrjete/shërbime të komunikimeve fikse.

9. “Operatori i bazës së të dhënave referencë të centralizuar (Operatori i CRDB)” nënkupton një subjekt (person juridik) i, i cili mirëmban dhe menaxhon funksionimin e platformës dhe sistemeve të operimit të instaluara në CRDB sipas përcaktimeve ligjore e nënligjore.

10. “Pajtimtar” është cilido që ka lidhur një kontratë me parapagesë ose pas pagesë me një operator që ofron shërbime të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun, për përfitimin e shërbimeve të ofruara.

11. “MSISDN” është një numër kombëtar N(S)N unik, i cili identifikon pajtimtarin e operatorit të rrjetit të komunikimit të lëvizshëm.

12. **“Numër Aktiv”<sup>2</sup> në kuptimin e kësaj rregulloreje është një numër i cili i ka të aktivizuar shërbimin telefonik pra që mund të dërgojë dhe/ose marrë thirrje apo mesazhe komunikimi nëpërmjet rrjetit fiks apo celular të operatorit me të cilin pajtimtari ka një kontratë pajtimi të vlefshme (me mënyrë pagese paspagim dhe/ose parapagim). Kontrata vazhdon të jetë në fuqiedhe nëse pajtimtarit i janë pezulluar përkohësisht shërbimet. Një numër celular me parapagim quhet aktiv në kuptim të kësaj rregulloreje për sa kohë është në gjendje të dërgojë dhe/ose marrë komunikime në kohën e kërkesës për portim.**

13. **“Numër i Çaktivizuar”<sup>3</sup> në kuptimin e kësaj rregulloreje është një numër i cili nuk është më aktiv në rrjetin e operatorit fiks ose celular sipas përkufizimit të pikës 12 më sipër.**

14. **“Numri Personal i Identifikimit”<sup>4</sup>- Është numri unik personal në Kartën e Identitetit, Pasaportën, e cdo shtetasi Shqiptar ose të huaj me banim të përhershëm ose të**

<sup>2</sup> Pika 12 aktualisht është: “Aktiv” në kuptimin e kësaj rregulloreje, një numër është në statusin “aktiv” nëse ka të aktivizuara shërbimet e përcaktuara në kontratën e pajtimit.

<sup>3</sup> Pika 13 aktualisht është: “Çaktivizuar” në kuptimin e kësaj rregulloreje një numër është në statusin “çaktivizuar” nëse ka të pezulluara të gjitha ose disa nga shërbimet e përcaktuara në kontratën e pajtimit.

**përkohshëm në Republikën e Shqipërisë dhe që shërben si kriteri kryesor i identifikimit të pajtimtarit.**

15. **Miratimi: tërësia e verifikimeve nga operatori Dhënës për të kontrolluar saktësinë dhe plotësinë e kërkesës së dërguar nga operatori Marrës me qëllim shmangien e gabimeve në ekzekutimin e portabilitetit të numrit.**

16. **Refuzim: refuzim i kërkesës për portim për shkak të mos-miratimit të saj nga operatori Dhënës në bazë të kritereve të përcaktuara në këtë rregullore.**

## **Neni 5**

### **Fusha e zbatimit**

1. Kjo rregullore zbatohet vetëm për bartjen e numrave fiks, bartje fiks-në-fiks dhe numrave të lëvizshëm, bartje numër i lëvizshëm-në-numër i lëvizshëm;
2. Një numër fiks mund të bartet në rrjetin e operatorit Marrës, vetëm nëse përdorimi i tij pas bartjes do të jetë në përputhje me Planin Kombëtar të Numeracionit dhe Rregulloren Nr.10, për “Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike dhe Planit Kombëtar të Numeracionit”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 932 datë 11.08.2009, e ndryshuar;
3. Nuk është e domosdoshme që operatori Marrës të ofrojë shërbim telefonik fiks në adresën e njëjtë të pajtimtarit siç është ofruar nga operatori Dhënës ose në adresën e kërkuar nga pajtimtari, në varësi të mundësive teknike për të ofruar shërbimin.
4. Një numër i lëvizshëm mund të bartet vetëm në rrjete të komunikimit të lëvizshëm.
5. Portabiliteti i numrit ndjek parimin e neutralitetit të teknologjisë. Nuk kërkohet që operatori Dhënës dhe operatori Marrës të përdorin teknologjinë e njëjtë për të ofruar shërbime publike telefonike.
6. Vetëm numrat të cilat janë **Aktivë sipas përkufizimit në këtë Rregullore (neni 4, pika 12)** mund të barten.<sup>5</sup>
7. Aplikimi teknik i portabilitetit të numrit nuk parandalon zgjerimin e mëvonshëm të fushëveprimit të dispozitave ligjore për portabilitetin e numrit. Baza e të dhënave referencë e centralizuar do të mund të mbështesë bartjen e të gjithë numrave të planit kombëtar të numeracionit.

## **Kapitulli II**

### **Mënyra e zbatimit të portabilitetit të numrit dhe sigurimi i disponueshmërisë së CRDB**

---

<sup>4</sup> Pikat 14-16 janë shtuar si përkufizime të reja.

<sup>5</sup> Pika 6 aktualisht është: *Vetëm numrat të cilat janë subjekt i një kontrate me pajtimtarin mund të barten. Kontrata mund të jetë me parapagesë ose pas pagesë.*



## Neni 6

### Zgjidhjet teknike

1. Të gjithë operatorët janë të detyruar të përshtatin dhe përmirësojnë rrjetet e tyre, në mënyrë që këto rrjete të mundësojnë bartjen e numrit si dhe të zhvillohen dhe të përmirësohen paralelisht me rritjen e numrave të bartur.
2. Të gjithë operatorët duhet të krijojnë një bazë të dhënash lokale pasqyre të numrave të bartur (LBPS) duke përfshirë informacionin e të gjithë numrave të bartur në Republikën e Shqipërisë.
3. Të gjithë operatorët, lidhur me procesin e bartjes së numrit, janë të detyruar të shkëmbejnë në mënyrë të ndërsjellët informacionin, mbi përdorimin e numrave të bartur, në CRDB, e cila regjistron të gjitha statet e bartjes së numrave.
4. Komunikimi midis operatorëve marres dhe Dhënës për bartjen e numrave realizohet vetem nëpërmjet CRDB.

## Neni 7

### Informacioni mbi numrat e bartur

1. Informacioni rreth numrave të bartur ruhet në bazën e të dhënave lokale pasqyre të numrave të bartur (LBPS) te operatoreve dhe në CRDB, e cila është një bazë të dhënash referuese.
2. CRDB ofron informacion për çdo numër të bartur, në rrjetin në të cilin numri i bartur ka qenë i vendosur para bartjes, në rrjetin në të cilin numri vendoset pas bartjes si për datën dhe orën e saktë kur bartja do të bëhet efektive. Të gjithë operatorët të cilët rrugëzojnë thirrje tek numrat fiks dhe të lëvizshëm do të sinkronizojnë bazën e të dhënave lokale pasqyre me bazën e të dhënave referencë të centralizuar së paku çdo gjashtë orë.

## Neni 8

### Rrugëzimi i thirrjeve drejt numrave të bartur

1. Operatorët e rrjeteve publike telefonike ose shërbimeve telefonike të disponueshme për publikun nëpërmjet automatizimit të plotë të procesit duhet të mbështesin rrugëzimin e thirrjeve drejt numrave të bartur fiks dhe të lëvizshëm. Mënyra e përzgjedhur e rrugëzimit është “all call query-kërkimi për çdo thirrje”.
2. Operatori i rrjetit dhe shërbimeve të lëvizshme, në të cilën origjinohet thirrja, është përgjegjës për rrugëzimin e thirrjes (transferim direkt), ose dërgimin e mesazheve drejtuar numrave të bartur në të gjitha rrjetet, në të cilat numrat e bartur janë vendosur, në përputhje me specifikimet teknike të standardit ETSI TS 123 066.
3. Operatorët e komunikimeve elektronike të shërbimeve publike të telefonisë fikse, si dhe operatorët që tranzitojnë thirrjet midis rrjeteve, janë përgjegjës për rrugëzimin e duhur

direkt të thirrjeve në numrat e bartur të rrjeteve të tjera fikse duke përdorur metodën e " *All Call Query – kërkimi për çdo thirrje* ".

4. Operatorët e komunikimeve elektronike të shërbimeve publike të telefonisë se levizshme, në rrjetin e të cilit gjenerohen thirrjet dhe operatorët të cilët rrugëzojnë thirrje nga rrjete të tjera, janë direkt përgjegjës për rrugëzimin e duhur të thirrjeve në numrat e bartur në rrjetet e komunikimeve elektronike publike të lëvizshme sipas metodës " *All Call Query - kërkimi për çdo thirrje* ".
5. Operator i komunikimeve elektronike publike, rrjeti i të cilit merr një kërkesë për vendosjen e një thirrje / mesazhi ndërkombëtar drejtuar një numri të bartur, është përgjegjës për rrugëzimin e duhur në rrjetin ku ndodhet aktualisht numri i bartur sipas rasteve të mëposhtme:
  - a) Në rast të shërbimeve të (para)zgjedhjes së bartësit, operatori i cili ofron shërbimin e (para)zgjedhjes së bartësit;
  - b) Në rast të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare, operatori i parë në Republikën e Shqipërisë i cili merr thirrjen/mesazhin ndërkombëtar dhe
  - c) Në të gjitha rastet e tjera, operatori në rrjetin e të cilit është origjinuar thirrja.
6. Operatorët mund të përmbushin detyrimet e vendosura në këto nen vetë ose nëpërmjet të marrëveshjeve kontraktore me një operator tranzitues.

## **Neni 9**

### **Njoftimi i numrit të bartur**

1. Operatorët janë të detyruar t'i njoftojnë nëpërmjet një mesazhi zanor në formën beep tone, pajtimtarëve të tyre, bartjen e numrit, përpara kryerjes së thirrjes drejt numrave të bartur.
2. Beep tone do të jetë i njëjtë për të gjithë operatorët e do të shërbejë për të njoftuar pajtimtarët se numri është bartur

## **Neni 10**

### **Baza e të dhënave referencë të centralizuar (CRDB)**

1. Për shkëmbimin e të dhënave mbi numrat e bartur ndërmjet bazave lokale pasqyre të të dhënave të numrave të bartur (LBPS) përdoret baza e të dhënave referencë të centralizuar (CRDB)
2. CRDB përmban të gjithë numrat e bartur, kodet për rrugëzimin e thirrjeve në numrat e bartur dhe transaksionet midis operatorëve (operatorët, emrat e dhuruesve dhe numrin e operatorëve Marrës të numrave, datat, numri i transfertave, informacion mbi statusin e procesit të bartjes së numrave).
3. AKEP siguron disponueshmërinë e CRDB sic parashikohet në këtë Rregullore. AKEP kryen procedurat për të garantuar dhe siguruar platformën dhe sistemet e operimit. Mirëmbajtja dhe menaxhimi i funksionimit të platformës dhe sistemeve të instaluar në CRDB kryhet nga operatori i CRDB.

4. Për të siguruar funksionimin e vazhdueshëm, sa më cilësor dhe të besueshëm të CRDB, përpara përfundimit të kontratës ekzistuese me operatorin e CRDB, AKEP do të kryejë një proces këshillimi publik me palët e interesuara për mënyrën e përzgjedhjes së operatorit të CRDB.

5. AKEP, për vlerësimin e performancës së CRDB, 6 muaj përpara përfundimit të kontratës me operatorin e CRDB, kryen një proces komunikimi formal me palët e interesuara.

6. Operatori i CRDB duhet të jetë një shoqëri tregtare e krijuar dhe regjistruar sipas legjisllacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, i cili garanton paanshmëri dhe besueshmëri tek operatorët e sistemit të bartjes së numrit. Kërkesat për garantimin e kriterit të paanshmërisë dhe besueshmërisë përcaktohen nga AKEP sipas legjisllacionit, në dokumentet e procedurës së përzgjedhjes së operatorit CRDB.

7. Operatori i CRDB është përgjegjës për operimin e platformës dhe garanton disponueshmërinë e funksioneve të bazës së të dhënave.

8. Specifikimet teknike për ambientin e hostimit të platformës dhe sistemeve të operimit të CRDB do të përcaktohen përkatësisht në procedurën e përzgjedhjes së operatoreve ekonomik.

9. Operatori është i detyruar të zbatojë parashikimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale.

**10. AKEP bazuar në raportet dhe statistikat e prodhuara nga CRDB do të publikojë periodikisht raporte tremujore që përmbajnë informacion dhe statistika për bartjen e numrave, performancën e CRDB dhe operatorëve për portimin e numrave, sipas treguesve në Aneks 3 të kësaj Rregulloreje.**<sup>6</sup>

## Neni 11

### Njoftimi paraprak i përdoruesve

1. Në rrjetin origjinues, operatori është i detyruar që t'i përcjellë një "beep tone" thirrësit kur kryen thirrje drejt një numri të bartur.

2. Operatorët duhet të informojnë pajtimtarët për mundësitë e mësipërme të këtij neni dhe mënyrën e paraqitjes së një kërkesë në përputhje me rekomandimet përkatëse (rekomandime mbi transparencën dhe publikimin e informacionit).

3. AKEP ofron një faqe interneti me adresë: [www.portabiliteti.al](http://www.portabiliteti.al) me informacion rreth procesit të bartjes së një numri me qëllim që të interesuarit përveç të tjerash të mund të informohen edhe në lidhje me tarifën e thirrjes.

## Neni 12

### Përdorimi i kodeve të rrugëzimit

---

<sup>6</sup> Pika 10 e nenit 10 është shtuar si përcaktim i ri. AKEP do të fillojë publikimin e raporteve periodike menjëherë pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të kësaj rregulloreje.

1. Për transferimin e thirrjeve në numrat e bartur përdoren kodet e rrugëzimit të përcaktuara nga AKEP sipas specifikimeve specifikuar në Rregulloren Nr.10, për “Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike dhe Planit Kombëtar të Numeracionit”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 932 datë 11.08.2009, e ndryshuar.

2. AKEP me qëllim rrugëzimin e thirrjeve në numrat e bartur të operatorëve është i detyruar të sigurojë caktimin e kodeve të rrugëzimit të portabilitetit të numrit.

3. Kodi i rrugëzimit në paragrafin e mësipërm përkufizohet si më poshtë:

Vlera numerike e Prefiksit të Rrugëzimit për Portabilitetin e Numrit:

99 X<sub>1</sub>X<sub>2</sub> ku:

- a) 99 - kodi i aksesit për portabilitetin e numrit,
- b) X<sub>1</sub>X<sub>2</sub> - është numri identifikues i sipërMarrësit që ofron shërbimin.

4. Operatori është i detyruar të sigurojë që pajtimtari të mos zgjedhë kodet e rrugëzimit. Çdo përpjekje e tillë duhet të kapet dhe të refuzohet nga sistemi.

5. Operatorët janë të detyruar të përdorin kodin e rrugëzimit për rrugëzimin e thirrjeve në numrat e bartur.

### Neni 13

#### Mundësa e bartjes dhe kërkesa për bartjen e numrit

1. Procesi i bartjes është i bazuar në parimin “one-stop”. Një pajtimtar i cili dëshiron të bart numrin, bën një kërkesë për mundësinë e bartjes së numrit tek Operatori Marrës.

2. Pajtimtari duhet të jetë **në zotërim të një Numri Aktiv telefonik sipas përkufizimit në nenin 4, pika 12 të kësaj Rregulloreje për të pasur mundësinë e portimit të numrit.**<sup>7</sup>

3. **Procesi për bartjen e numrit udhëhiqet nga operatori Marrës (recipient-led), pra Operatori Marrës është përgjegjës për dërgimin e kërkesës për portim të pajtimtarit tek Operatori Dhënës, ndjekjen e procesit të bartjes së numrit dhe dërgimin e njoftimeve përkatëse pajtimtarit për procesin sipas përcaktimeve në këtë Rregullore.**

4. Formulari i aplikimit për portabilitetin e numrit për përdoruesit paraqitet bashkëlidhur kësaj rregulloreje. Aneksi 1 përmban tipet e dokumenteve dhe të dhënat të nevojshme që pajtimtari duhet të plotësojë në kërkesën për portim.

### Neni 14

#### Detyrimet e operatorit Marrës

1. Para fillimit të procesit të bartjes të numrit operatori Marrësi është i detyruar të verifikojë identitetin e përdoruesit apo pajtimtarit. Identifikimi i pajtimtarit kryhet me anë të një dokumenti që vërteton identitetin e personit<sup>8</sup> **apo Numrin Personal të tij nëpërmjet një dokumenti të vlefshëm identifikues:**

<sup>7</sup> Neni 13 aktualisht ka vetëm dy pika. AKEP propozon ndryshimin e pikës 2 dhe përfshirjen e dy pikave të reja 3 dhe 4 si më sipër. Pika 2 e nenit 13 aktualisht është: *Pajtimtari duhet të jetë përdorues i shërbimit me parapagesë ose pas pagesë tek operatori dhënës që të paraqesë numrin MSISDN tek operatori marrës. Kërkesa për transferimin e numrit përfundohet nga operatori marrës. Formulari i aplikimit për portabilitetin e numrit për përdoruesit paraqitet bashkëlidhur kësaj rregulloreje. Aneksi 1 përmban tipet e dokumenteve dhe të dhënat të nevojshme.*

<sup>8</sup> Pika 1 e nenit 14 është ndryshuar me qëllim saktësimin për identifikimin e pajtimtarit dhe është në linjë me ndryshimet e tjera të propozuara në këtë rregullore që Numri Personal Unik i cdo personi në RSH të jetë mënyra

- Kartë Identiteti ose
- Pasaportë.

**Operatori Marrës regjistron të dhënat e pajtimtarit të portuar sipas formularit përkatës të regjistrimit të miratuar nga AKEP në përputhje me nenin 100 të ligjit 9918. Operatori Marrës mban kopje të Kartës së Identitetit ose Pasaportës të pajtimtarit dhe do t'i ruajë ato në dosjen e pajtimtarit/kontratës.**

2. **Operatori Marrës duhet t'i dërgojë Operatorit Dhënës kërkesën për bartjen e numrit bazuar në kërkesën e pajtimtarit sipas formularit në Aneks 1 në kohën e përcaktuar në këtë formular.** Operatori marrës ka detyrim të pajisë pajtimtarin me një kopje të printuar ose elektronike të kërkesës për portim sipas formularit në Aneks 1.<sup>9</sup>

3. Operatori Marrës është i detyruar të sigurojë që përdorimi i numrit pas importimit është në përputhje me rregullat për përdorimin e numrave të Rregullores Nr.10, për “Caktimin dhe Përdorimin e Numrave dhe Serive Numerike dhe Planit Kombëtar të Numeracionit”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 932 datë 11.08.2009, e ndryshuar.

4. Operatori Marrës duhet të informojë pajtimtarin i cili bën kërkesë të bartë numrin, në lidhje me procesin e transferimit të numrit për:

- a) periudhën se kur do te kryhet procesi i bartjes,
- b) periudhën se kur do t'i fillojë aktivizimi i shërbimit në rrjetin e tij,
- c) shërbimet e rrjetit të operatorit Marrës,
- d) përgjegjësitë dhe kushtet e transmetimit të njoftimeve paralajmëruese për pajtimtarët kur thirrësi telefonon në numrat e bartur;
- e) arsyet për refuzimin te kërkesës për bartjen e numrave;
- f) arsyet e vonesave në transferimin e numrave.

5. Nëse operatori Marrës drejton procesin e bartjes pa autorizimin e pajtimtarit, numri do të kthehet në rrjetin e operatorit Dhënës dhe pajtimtari dhe operatori Dhënës kanë të drejtë të kërkojnë kompensim për dëmin.

6. **Për përfitimin e shërbimeve në rrjetin e tij, përveç informacionit të kërkuar nga neni 99 i ligjit 9918, i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nën-ligjore, operatori marrës është i detyruar t'i ofrojë pajtimtarit që bën kërkesën për portim të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti informacionin në Aneks 2 të kësaj Rregulloreje, përfshirë:**<sup>10</sup>

---

e identifikimit të pajtimtarëve, sidomos për procesin e portimit. Ky numër është unik dh është i njëjtë në të gjitha dokumentat e indentifikimit në Shqipëri dhe po përdoret gjerësisht edhe Qeveria e RSH për shërbimet ICT dhe e-government. Përcaktimi aktual i pikës 1 është: *Para fillimit te procesit te bartjes të numrit operatori marrësi është i detyruar të verifikojë identitetin e përdoruesit apo pajtimtarit. Identifikimi i pajtimtarit kryhet me anë të një dokument që vërteton identitetin e personit. Operatori marrës duhet të verifikojë identitetin e pajtimtarit sipas nenit 100 të ligjit 9918.*

<sup>9</sup> Pika 2 e nenit 14 aktualisht është: *Operatori Marrës duhet ti dërgoje Operatorit Dhënës kërkesën për bartjen e numrit bazuar ne kërkesën e pajtimtarit sipas formularit ne Aneks 2 . Operatori Marrës do të ruaj dokumentet origjinale në formë shkresore*

<sup>10</sup> Pika 6 e nenit 14 është shtuar duke përfshirë përcaktimet e pikës 4 të nenit 17, por me disa ndryshime/saktësime. Pika 4 e nenit 17 (propozuar të jetë pika 6 e nenit 14) aktualisht është: *Përveç informacionit të kërkuar nga neni 99 i ligjit 9918, i ndryshuar, operatori marrës është i detyruar ti ofrojë pajtimtarit të gjithë informacionin e nevojshëm, në veçanti:*

*a) që bartja do të përfundojë kontratën ekzistuese të pajtimtarit me operatorin dhënës, por nuk do ti përfundojë detyrimet kontraktore të cilat tashmë ekzistojnë;*

- a) që bartja do të përfundojë kontratën ekzistuese të pajtimtarit me operatorin Dhënës, por nuk do të përfundojë detyrimet kontraktore të cilat tashmë ekzistojnë me operatorin Dhënës:
- i. kërkesa për bartje për një numër me paspagim mund të pranohet nga operatori Dhënës por nuk mund të miratohet (do jetë në status Pezull) deri në shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të pajtimtarit ndaj operatorit Dhënës sipas përcaktimeve të kontratës ekzistuese midis tyre;
  - ii. në rastin e aplikimit të pikës së mësipërme (i) operatori Marrës do njoftojë me SMS apo Telefonatë pajtimtarin që të drejtojë të gjitha pyetjet lidhur me shumën e detyrimeve të papaguara dhe pagesa të tjera të mundshme operatorit Dhënës si dhe të kryejë ato në mënyrë që të ekzekutohet kërkesa për portim;
- b) cdo detyrim që pajtimtari duhet ti paguajë operatorit Marrës; dhe
- c) nëse është e nevojshme, specifikimet teknike të ndërfaqes së rrjetit të operatorit Marrës dhe nëse pajtimtari do të mund të përdorë pajisjet fundore ekzistuese;

## Neni 15<sup>11</sup>

### Operatori Dhënës

1. Operatorët Dhënës të cilët përdorin numra fiks ose të lëvizshëm duhet të mbështesin sipas përcaktimit në nenin 16 procesin e bartjes.
2. Operatori Dhënës nuk është i detyruar të eksportojë numrin nëse ky numër nuk është Aktiv sipas përcaktimit në nenin 4, pika 12 të kësaj rregulloreje.<sup>12</sup>
3. Operatori Dhënës është i detyruar të kryejë bartjen e numrit edhe kur shërbimet e kontraktuara me pajtimtarin janë pezulluar ose ndërprerë në mënyrë të njëanshme përpara konsiderimit të përfunduar të kontratës sipas përcaktimeve të parashikuara në Rregulloren Nr. 31, datë 26.12.2013 “Për Termat e Përgjithshme të Kontratës së Pajtimtarit për lidhjen dhe aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike” (Seksioni VIII: Vazhdimi dhe Ndërprerja e Shërbimeve). Në rastet kur për shkak të mos pagesës së faturës mujore pajtimtari gjendet në kushtet e ndërprerjes së njëanshme të shërbimeve të kontraktuara, operatori Dhënës është i detyruar të pranojë kërkesën për bartje por bartja do të përfundojë vetëm kur pajtimtari të ketë shlyer detyrimin e prapambetur të faturës së papaguar.
4. Operatori Dhënës është i detyruar të rregullojë kriteret e eksportimit të numrit nga rrjeti i tij në termat e përgjithshme të kontratës së pajtimtarit për shërbimin publik telefonik.<sup>13</sup>

- 
- b) *që pajtimtari duhet ti paguajë operatorit dhënës të gjitha detyrimet e papaguara, duke përfshirë edhe tarifën për portabilitetin e numrit dhe/ose kompensimin nëse kontrata është ndërprerë para kohëzgjatjes minimale të kontratës së rënë dakord.*
- c) *që pajtimtari duhet ti drejtojë të gjitha pyetjet lidhur me shumën e detyrimeve të papaguara dhe pagesa të tjera të mundshme operatorit dhënës;*
- d) *çdo detyrim që pajtimtari duhet ti paguajë operatorit marrës; dhe*
- e) *nëse është e nevojshme, specifikimet teknike të ndërfaqes së rrjetit të operatorit marrës dhe nëse pajtimtari do të mund të përdorë pajisjet fundore ekzistuese;*

<sup>11</sup> Në nenin 15 janë ndryshuar pikat 2, 6 dhe 7 aktuale, janë hequr Pikat 3 dhe 4 dhe është bërë ndryshimi i numrit rendor të paragrafëve.

<sup>12</sup> Pika 2 e nenit 15 aktualisht është: *Operatori Dhënës nuk është i detyruar të eksportojë numrin nëse ky numër nuk është subjekt i një kontrate efektive, me parapagesë ose me pas pagesë.*

**5. Në rast se një numër i portuar kalon në statusin Numër i Caktivizuar, sipas përcaktimit në Nenin 4, pika 13 e kësaj Rregulloreje, ose numri i hiqet pajtimtarit për shkaqe të përcaktuara në aktet ligjore dhe nën-ligjore, ky numër i bartur i kalon operatorit Dhënës fillestar, i cili zotëron të drejtën e përdorimit të numrit nga AKEP. Operatori Marrës njofton operatorin Dhënës fillestar për këto numra duke përditësuar dhe informacionin në CRDB.<sup>14</sup>**

**6. Operatori Dhënës pas marrjes së kërkesës për portim nga operatori Marrës ndalohet të japë oferta/bonuse apo kushte të tjera favorizuese individuale për pajtimtarin që ka bërë kërkesë për portim.<sup>15</sup>**

## Neni 16<sup>16</sup>

### Të drejtat dhe detyrimet e pajtimtarit

1. Portabiliteti i numrit është e drejtë e pajtimtarit në marrëdhëniet e tij kontraktore me operatorin Dhënës dhe atë Marrës. Pajtimtari ka të drejtën të mbajë numrin kur ndryshon operatorin.
2. Një pajtimtar mund të bartë numrin duke nënshkruar kontratë me operatorin Marrës dhe duke shprehur dëshirën të nderprese kontratën me operatorin Dhënës dhe të bartë numrin. Kontrata e vjetër dhe ajo e reja mund të jenë me parapagesë ose pas pagesë.
3. Veprimi i bartjes nderpret kontratën mes pajtimtarit dhe operatorit Dhënës, por nuk i përfundon detyrimet kontraktore të cilat ekzistojnë para bartjes. Për ekzekutimin me sukses të portimit, pajtimtari me paspagim është i detyruar të paguajë (shlyejë) të gjitha detyrimet e prapambetura (faturat e papaguara që u ka kaluar afati i pagesës deri në marrjen e kërkesës për portim nga operatorin dhënës) sipas kontratës ekzistuese me operatorin dhënës, dhe njoftimeve përkatëse sipas parashikimeve të kësaj rregulloreje..
4. Asnjë kontratë mes pajtimtarit dhe operatorit nuk mund përjashtojë të drejtën e pajtimtarit për të bartur numrin. Klauzolat e kontratës të cilat përjashtojnë ose kufizojnë të drejtën e pajtimtarit për të bartur numrin janë të pavlefshme.
5. Pajtimtari duhet te perfundoje të gjitha detyrimet qe vijne si rezultat i perfitimeve te marra nga kontrata ekzistuese qe perfshijne aparate telefonike apo pajisje te ndryshme, duke rimbursuar vetem vleren e mbetur perpara ekzekutimit te kerkeses per bartje.
6. Koha minimale e detyrueshme për kërkuesin e bartjes që të qëndrojë në operatorin në të cilin është bartur, përpara se të vendosë një kërkesë tjetër për bartje është 3 muaj.” Pas 3 muajve, pajtimtarit i lind e drejta e bartjes sërish të numrit.

---

<sup>13</sup> Pika 6 e nenit 15 aktualisht është: *Operatori Dhënës është i detyruar të rregullojë kriteret e eksportimit të numrit nga rrjeti i tij në kushtet ose kontratën e përgjithshme të biznesit.*

<sup>14</sup> Pika 7 e nenit 15 aktualisht është: *Me përfundimin e kontratës së një numri të bartur, operatorin Dhënës fillestar mbetet mbajtësi i të drejtës për përdorimin e numrit.*

<sup>15</sup> Pika 6 është shtuar si parashikim i ri për të parandaluar praktikat e pandershme tregtare.

<sup>16</sup> Në nenin 16 është hequr pika 5 që aktualisht është: *Pajtimtari duhet ti paguaj operatorit Dhënës të gjitha faturat e papaguara që dalin nga kontrata ekzistuese përpara ekzekutimit të kërkeses për bartje.* Heqja e kësaj pike është kryer për shkak të përsëritjes së panevojshme të të njëjtit detyrim. Pikat e tjera kanë ndryshuar numrin rendor.

**7. Tarifa e eksportimit të numrit paguhet nga operatori marrës. Tarifa për eksportimin e numrit paguhet nga operatori Marrës dhe nuk duhet të jetë më e lartë se 600 Lek (me TVSH).**<sup>17</sup>

8. Pajtimtarët janë të detyruar që të njoftojnë sipërMarrësin me të cilin kanë lidhur kontratën e pajtimit, për çdo ndryshim të të dhënave të tyre të regjistruara në bazën e të dhënave të sipërMarrësit të bazuar në dokumentacionin perkates. **Gjatë procesit të ekzekutimit të kërkesës për portim, pajtimtari mund të ketë nevojë për saktësim të identifikimit në rrjetin e operatorit Dhënës sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.**<sup>18</sup>

## Neni 17

### Procedura administrative e bartjes

- 1. Procesi për bartje niset nga pajtimtari. Pajtimtari kontakton operatorin Marrës dhe shpreh me shkrim vullnetin për të lidhur kontratë/përfitur shërbime prej tij dhe për të bartur numrin e caktuar sipas Aneksit 2 të kësaj rregulloreje. Operatori Marrës informon pajtimtarin për të drejtat dhe detyrimet sipas përcaktimeve në këtë rregullore.**<sup>19</sup>
- 2. Pasi Operatori Marrës ka përfunduar identifikimin dhe informimin e pajtimtarit sipas përcaktimeve në këtë Rregullore dhe është i gatshëm të nënshkruajnë një kontratë (me paspagim ose parapagim) me pajtimtarin dhe të importojë numrin, dhe pajtimtari bie dakort për termat dhe kushte e ofrimit të shërbimit nga operatori Marrës, pajtimtari plotëson dhe nënshkruan Formularët përkatës për portimin e numrit sipas Aneks 1 dhe Aneks 2 të kësaj rregulloreje. Afatet për procesin e bartjes llogariten duke filluar nga Data dhe Koha e Kërkesës së pajtimtarit për bartje të numrit të përcaktuara në formularin në Aneks 1 të kësaj Rregulloreje.**<sup>20</sup>
- Në kohën kur operatori marrës dërgon kërkesën për bartjen e numrit në CRDB, pajtimtari nuk mund të kërkojë anulimin e procesit të bartjes së numrit.
- Operatori Marrës do të kontrollojë aplikimin e pajtimtarit sipas procedurave të zakonshme dhe do të vazhdojë me procesin e bartjes vetëm nëse ai dëshiron të lidhë kontratë me pajtimtarin dhe mund të importojë numrin e kërkuar. Nëse operatori Marrës nuk e pranon ose e refuzon aplikimin e pajtimtarit brenda tri ditëve të punës,

<sup>17</sup> Pika 8 e nenit 16 aktualisht është: *Kontrata mes pajtimtarit dhe operatorit mund të parashikojë që pajtimtari të paguajë një tarifë për eksportimin e numrit. Kjo tarifë mund të mbulojë koston e ndryshimit mes përfundimit të zakonshëm të kontratës dhe ndërprerjes lidhur me bartjen e numrit. Kosto e cila mbulohet nga operatori marrës nuk paguhet nga pajtimtari. Tarifa për eksportimin e numrit nuk duhet të jetë më e lartë se 600 Lek (me TVSH)*

<sup>18</sup> Në pikën 9 të nenit 16 është shtuar paragrafi i nënvizuar dhe bold.

<sup>19</sup> Pika 1 e nenit 17 aktualisht është:

*Procesi për bartje niset nga pajtimtari. Pajtimtari kontakton operatorin Marrës dhe shpreh dëshirën për të lidhur kontratë dhe për të bartur numrin e caktuar.*

<sup>20</sup> Pika 2 e nenit 17 aktualisht është: *Nëse pajtimtari ose përdoruesi paraqet kërkesën për bartjen e numrit sipas Aneks 1, operatori Marrës njofton operatorin Dhënës nëpërmjet CRDB për bartjen e numrit dhe datën e dëshiruar të transferimit*



pajtimtari do të tërheqë aplikimin e tij. Në rast se operatori Marrës refuzon ofrimin e shërbimeve për pajtimtarin ai e informon atë me shkrim (SMS, email, letër etj), përfshirë arsyet e refuzimit.<sup>21</sup>

## Neni 18

### Kërkesa dhe përgjigja për bartje

1. Menjëherë me plotësimin nga pajtimtari të kërkesës për bartjen e numrit sipas nenit 17 të kësaj rregulloreje, Operatori Marrës dërgon në CRDB kërkesën për bartje. Kërkesa për bartje përmban dhe është sipas formularit ne Aneksin I të kësaj Rregulloreje.<sup>22</sup>
2. Operatori Dhënës njoftohet nëpërmjet CRDB për kërkesën për bartjen e numrit, përfshirë dhe datën e dëshiruar të transferimit sipas Formularit në Aneks I.
3. Baza e të dhënave referencë e centralizuar menjëherë kontrollon saktësinë e kërkesës për bartje sa më shpejt të jetë e mundur, në veçanti nëse numri i cili do të bartet është numër gjeografik ose i lëvizshëm dhe nëse numri është saktësisht i vendosur në rrjetin e operatorit Dhënës. Në rast se zbulohet ndonjë gabim, baza e të dhënave referencë e centralizuar menjëherë i dërgon mesazh për gabimin operatorit Marrës. Operatori Marrës është i detyruar që në bashkëpunim me operatorin Dhënës dhe pajtimtarin të kryejnë brenda afatit të përcaktuar në këtë rregullore korrigjimin e gabimit të konstatuar në kërkesën për bartje.
  - a. Në rast se zbulohet ndonjë gabim, baza e të dhënave referencë e centralizuar menjëherë i dërgon mesazh për gabimin operatorit Marrës.
  - b. Nëse baza e të dhënave referencë e centralizuar nuk zbulon ndonjë gabim, menjëherë regjistron kërkesën për bartje, cakton një numër referencë dhe konfirmon pranimin e kërkesës, duke përfshirë numrin e caktuar të referencës. Baza e të dhënave referencë e centralizuar menjëherë ridrejton kërkesën për bartje operatorit Dhënës, duke përfshirë numrin e caktuar referencë.
4. Kur operatori Dhënës merr një kërkesë për bartje, do të kontrollojë:
  - a) nëse numri që do të bartet është aktiv ose objekt i një kontrate të vlefshme (në fuqi) në rrjetin e operatorit Dhënës, dhe
  - b) nëse numri personal i identifikimit (ID) ose numri NIPT<sup>23</sup> i regjistrimit të pajtimtarit i paraqitur në kërkesën për bartje përputhet me detajet e pajtimtarit në bazën e të dhënave të operatorit Dhënës.
5. Pas ekzaminimit, operatori Dhënës do të dërgojë përgjigjen për bartje në bazën e të dhënave referencë të centralizuar. Përgjigja për bartje përmban:
  - a) numrin referencë të këtij procesi të bartjes;

<sup>21</sup> Në pikën 4 të nenit 17 është shtuar fjalia e fundit e nënvizuar. Në nenin 17 janë hequra pikat 4 (pika 4 është rishikuar dhe përfshirë në nenin 14) dhe pika 5 (përfshirë në pikën 2 të nenit 17)

<sup>22</sup> Pikat 1 dhe 2 të nenit 18 aktualisht janë:

1. Nëse operatori Marrës ka përfunduar të gjitha fazat e përshkruara në nenin 13 të kësaj rregulloreje dhe është i gatshëm të nënshkruajë një kontratë me pajtimtarin dhe të importojë numrin, operatori Marrës do të dërgojë kërkesën për bartje në bazën e të dhënave referencë të centralizuar.

2. Kërkesa për bartje përmban dhe është sipas formularit në Aneksin I.

<sup>23</sup> Përcaktimi në Pikën 4/b të nenit 18 aktualisht është: dhe nëse emri, data e lindjes ose (ID) dhe numri NIPT...

b) **Konfirmim (Miratim) ose refuzim (përgjigje negative);<sup>24</sup>**

c) në rast të përgjigjes negative, një tregues lidhur me arsyen e refuzimit të kërkesës për bartje. **Kërkesa do të refuzohet vetëm për arsyet e mëposhtëme:<sup>25</sup>**

aa) kërkesa për bartje pranohet por nuk mund të përfundohet sepse ky numër rezulton me detyrime të prapambetuara të papaguara;

bb) numri që do të bartet nuk është i vendosur në rrjetin e operatorit Dhënës;

cc) **numri i cili do të bartet nuk është Aktiv sipas përkufizimit në këtë Rregullore;<sup>26</sup>**

dd);

ee) **Numri Personal i Identifikimit (ID) të pajtimtarit i paraqitur në kërkesën për bartje nuk përputhet me ID-në e pajtimtarit në bazën e të dhënave të operatorit Dhënës;**

ff) numri NIPT i pajtimtarit i paraqitur në kërkesën për bartje nuk përputhet me numrin NIPT të regjistrimit të pajtimtarit në bazën e të dhënave të operatorit Dhënës (Aplikohet vetëm për bizneset sipas formularit 1).

Në raste të përgjigjes negative sipas kësaj dispozite, operatori Dhënës është i detyruar të bashkëpunojë me pajtimtarin dhe operatorin Marrës për të mundësuar korrigjimin e gabimit të konstatuar në të dhënat e Pajtimtarit me qëllim realizimin e procesit të bartjes së numrit brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore.

6. Të gjithë operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të lëvizshme do të aplikojnë procesin e plotë të automatizimit për të ekzaminuar kërkesat për bartje. **Për operatorët celularë Dhënës, koha mes marrjes së kërkesës për bartje dhe përgjigjes nuk do të jetë më e gjatë se 5 minuta të të gjitha rasteve të muajit kalendarik.<sup>27</sup>**

<sup>24</sup> Kjo pikë aktualisht është: një përgjigje nëse është përgjigje pozitive ose negative

<sup>25</sup> Pjesa e nënvizuar aktualisht është: e cila mund të jetë vetëm një nga arsyet e mëposhtme. Në kriteret e refuzimit në pikën 5/c të nenit 18 është saktësuar kriteri “cc” dhe “ee” dhe është hequr kriteri “dd” që aktualisht është: emri i pajtimtarit i paraqitur në kërkesën për bartje nuk përputhet me emrin e pajtimtarit në bazën e të dhënave të operatorit dhënës. Ky përbën një ndër ndryshimet më të rëndësishme të Rregullores dhe siç është theksuar në ndryshimet e tjera, Numri Personal duhet të jetë mënyra kryesore e identifikimit dhe gabimet në emër/mbiemër, përfshirë ato njerëzore të mos-jenë kriter refuzimi kur përputhet Numri Personal Unik i ID-së.

<sup>26</sup> Kriteri cc aktualisht është: numri i cili do të bartet nuk është subjekt i një kontrate efektive.

<sup>27</sup> Pika 6 e nenit 18 aktualisht është:

*Të gjithë operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike të lëvizshme do të aplikojnë procesin e plotë të automatizimit për të ekzaminuar kërkesat për bartje. Për këta operatorë, koha mes marrjes së kërkesës për bartje dhe përgjigjes nuk do të jetë më e gjatë se 5 minuta në 90% të të gjitha rasteve të muajit kalendarik dhe jo më gjatë se 24 orë në 98% të të gjitha rasteve të vitit kalendarik. Koha mes pranimit të kërkesës për bartje dhe përgjigjes, në rastin e kërkesës për bartje të mbi 100 numrave të një pajtimtari, nuk do të jetë jo më gjatë se 3 ditë pune*

AKEP propozon që pika 6 dhe 7 të ndryshohen duke hequr përqindjet si dhe afatet e tjera duke lënë maksimumi 5 minuta kohe përgjigje nga operatori dhënës për rrjetet celulare dhe maksimumi 6 orë për rrjetet fikse për kërkesa individuale për portim. Për kërkesat balk (mbi 100 portime për pajtimtar) nuk janë ndryshuar afatet por janë nxjerrë si pika më vehte (7 për operatorët celularë dhe 9 për operatorët e rrjeteve fikse).

7. **Për operatorët celularë Dhënës**, koha mes marrjes së kërkesës për bartje dhe përgjigjes, në rastin e kërkesës për bartje të mbi 100 numrave të një pajtimtari, nuk do të jetë më e gjatë se 3 ditë pune.
8. Për operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike fikse, koha mes pranimit të kërkesës për bartje dhe përgjigjes nuk do të jetë më e gjatë se 6 orë **pune të të gjitha rasteve të muajit kalendarik.**
9. **Për operatorët fiks Dhënës**, koha mes marrjes së kërkesës për bartje dhe përgjigjes në rastin e kërkesës për bartje të mbi 100 numrave të një kontrate, nuk do të jetë më gjatë se 5 ditë pune.
10. **Numri maksimal i kërkesave që mund të pranohen në sistem nga operatori Dhënës brenda një dite pune është 3000. Numri maksimal i kërkesave që aprovohen për bartje brenda një dite pune nga operatori Dhënës është 2000.**<sup>28</sup>
11. Nëse operatori Dhënës nuk e dërgon përgjigjen për bartje brenda afateve të përcaktuara në paragrafët 5, 6, 7, 8 **dhe 9** te këtij neni baza e të dhënave referencë e centralizuar do të veprojnë sikur të ketë pranuar përgjigje pozitive për bartje.
12. <sup>29</sup>**Për numrat celularë me parapagim operatori Marrës ka të drejtë të kryejë një verifikim të pjesshëm nëse numri që kërkon të portohet është Aktiv ose jo në rrjetin e operatorit Dhënës:**
  - a. **OM dërgon një mesazh SMS në numrin MSISDN me parapagim të pajtimtarit që kërkon të portohet. Nëpërmjet SMS-së i kërkohet pajtimtarit që të konfirmojë me SMS saktësinë e informacionit për portimin e numrit për Emrin e OM dhe Emrin e ODH.**
  - b. **Pajtimtari konfirmon nëpërmjet SMS duke dhënë dhe Numrin Referencë të Bartjes (së dhënë nga ODH)**
  - c. **Me marrjen e një konfirmimi pozitiv sipas pikës b më sipër, OM njofton sa më shpejt ODH për verifikimin e pjesshëm dhe ODH nuk mund të përdorë arsyen (cc) apo (bb) për refuzim.**
  - d. **OM ruan gjurmët e komunikimit me SMS me pajtimtarin dhe mban përgjegjësi për realizim portimi pa kërkesë të pajtimtarit.**
13. **Në rast të refuzimit të kërkesës për bartje nga ODH, OM njofton menjëherë pajtimtarin për refuzimin dhe arsyet e refuzimit si dhe alternativat e korrigjimit të gabimeve. Për pajtimtarët celularë njoftimi kryhet me SMS:**
  - a. **Në rast të refuzimit për shkak të mos-përputhjes së ID, pajtimtari këshillohet të kontaktojë ODH për saktësim të të dhënave sipas mjeteve të identifikimit të përcaktuara në këtë rregullore.**
  - b. **Në rast të refuzimit për shkak të detyrimeve të pashlyera ndaj ODH, pajtimtari këshillohet të shlyejë ato sipas kontratës ekzistuese me ODH.**
14. **Me paraqitjen e pajtimtarit tek ODH, ky i fundit kryen menjëherë identifikimin dhe saktësimin e të dhënave të pajtimtarit sipas ID së paraqitur nga pajtimtari, për Numrin Personal.**
15. **Menjëherë, apo maksimumi brenda 1 (një) ore , ODH kryen pranimin e kërkesës për portim pas saktësimit të të dhënave të ID.**
16. **OM pranon kërkesa për portim cdo ditë pune nga ora 9.00-19.00. Operatorët mund të bien dakort për zgjatjen e orarit ose pranimin e kërkesave në ditë pushimi.**

<sup>28</sup> Pika 9 e nenit 18 aktualisht është: **Numri maksimal i kërkesave që mund të pranohen në sistem nga operatori dhënës brenda një dite pune është 1200. Numri maksimal i kërkesave që aprovohen për bartje brenda një dite pune nga operatori dhënës është 600.**

<sup>29</sup> Pikat 12-17 të nenit 18 janë shtuar si përcaktime të reja që synojnë lehtësimin dhe përshpejtimin e identifikimit të numrave aktive me parapagim celular si dhe në procesin e saktësimit të të dhënave të pajtimtarit. Pika 17 përfshin përcaktimin e ligjit 9918 të nenit 84, pika 9 ( e shtuar në amendimet e vitit 2012) duke synuar saktësime të realizimit të afatit 1 ditë pune.

**17. Koha e aktivizimit të numrit të portuar nuk duhet të jetë me gjatë se 24 orë nga koha e shënuar (data dhe ora) në formulaët e plotësuar nga pajtimtari të kërkesës për portim sipas Aneks 1 dhe 2 të kësaj rregulloreje. Përjashtim nga ky afat përbejnë rastet kur kërkesa duhet të procesohet gjatë ditëve të pushimit zyrtar ose kur kërkesa refuzohet nga ODH për shkak të arsyeve të përcaktuara në këtë rregullore. Në këto raste koha llogaritet nga momenti i pranimit të kërkesës nga operatori Dhënës.**

## **Neni 19**

### **Konfirmimi për bartje**

1. Kur baza e të dhënave referencë e centralizuar merr përgjigje pozitive për bartje nga operatori Dhënës, do të kalojë menjëherë atë tek operatori marrës dhe do të regjistrojë këtë informacion në bazën e të dhënave.
2. Operatori marrës nuk mund të zgjedhë kohën e bartjes me vone se në ditën pasardhëse të punës, përveç rasteve kur pajtimtari kërkon që bartja të realizohet në afat tjetër. Afati kohor mes konfirmimit të bartjes dhe kohës së bartjes do të jetë jo më shumë se gjashtë orë.
3. Baza e të dhënave referencë e centralizuar i përcjell menjëherë konfirmimin për bartje operatorit Marrës. Konfirmimi për bartje është konfirmim autentik për përfundimin e procesit të bartjes përmban :
  - a) numrin referencë të këtij procesi të bartjes;
  - b) numrin që do të bartet;
  - c) emrin e pajtimtarit,
  - d) kodin e operatorit Dhënës;
  - e) kodin e operatorit Marrës; dhe
  - f) datën dhe orën kur do të bëhet bartja.
4. Kur baza e të dhënave referencë e centralizuar merr përgjigje negative, do të ridrejtojë menjëherë përgjigjen tek operatori Marrës. Në këtë rast procesi i bartjes ka përfunduar pa sukses dhe në varësi të arsyes të dështimit operatori Marrës mund të fillojë një proces tjetër.
5. Pajtimtarit gjatë procesit të transferimit të numrit, mund t'i ndërpriten shërbimet e komunikimeve elektronike, të cilat duhet të rifillojnë sa më shpejt të jetë e mundur.

## **Neni 20<sup>30</sup>**

### **Rishikimi**

1. Çdo operator i cili përdor numra fiks ose të lëvizshëm do të emërojë një person kontakti, i cili do të ketë një numër telefoni si dhe një adresë email-i, i cili do të jetë përgjegjës për rastet të cilat nuk mund të zgjidhen nëpërmjet mesazheve standarde elektronike të përcaktuara në këtë kapitull. Baza e të dhënave referencë e centralizuar

---

<sup>30</sup> Është korigjuar numri rendor i nenit 17 dhe neneve 20 e në vijim.

do të ketë një faqe Intraneti me detajet e kontaktit të gjithë personave të kontaktit të operatorit.

2. Nëse kërkesa për bartje nuk mund të zgjidhet nëpërmjet shkëmbimit të mesazheve standarde elektronike, personi i kontaktit i operatorit Marrës do të kontaktojë drejtpërdrejtë personin e kontaktit të operatorit Dhënës. Duke respektuar parimin "one-stop-shop" të bartjes së numrit , operatorët duhet të gjejnë një zgjidhje brenda 8 orëve pune duke shkëmbyer dhe përditësuar të dhënat e sakta në interes të pajtimtarit dhe vazhdimit të procesit të bartjes
3. Nëse problemet e caktuara teknike ose operacionale përsëriten, operatorët dhe ofruesi i bazës së të dhënave referencë të centralizuar do të bashkëpunojnë në zgjerimin e specifikimeve teknike në mënyrë që të zgjidhet ky problem.

### **Kapitulli III** **Dispozita të fundit**

#### **Neni 21**

#### **Mbulimi i kostove financiare dhe pagesat**

1. AKEP, për të siguruar disponueshmërinë e CRDB, mbulon me fondin e shpenzimeve vjetore të tij, investimet e nevojshme për blerjen dhe zhvillimin e platformës dhe sistemeve të operimit të CRDB.
2. Operatorët mbulojnë kostot financiare të ofrimit të shërbimit të operatorit të CRDB si dhe hostimit të platformës.
3. Për mbulimin e kostove financiare të ofrimit të shërbimit të operatorit të CRDB si dhe hostimit të platformës, operatorët paguajnë për llogari të operatorit të CRDB dhe hostuesit një pagesë e cila llogaritet nga AKEP duke iu referuar:
  - a) Shumës së kontraktuar me operatorin e CRDB;
  - b) Shumës së kontraktuar me qiraDhënësin e ambienteve ku është hostuar CRDB;
  - c) Koeficientit të llogaritur mbi bazën e numrit të portimeve të kryera respektivisht nga operatorët në raport me numrin në total të portimeve të kryera (veç ne fiks dhe veç në të lëvizshëm) për vitin financiar të mëparshëm.
4. Pagesa e llogaritur për secilin operator sipas pikës 3 të këtij neni iu faturohet atyre nga AKEP në muajin janar të çdo viti korrent dhe ata janë të detyruar të kryejnë pagesën në numrin e llogarisë së përcaktuar në faturë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve pas marrjes së faturës.
- 5 Çdo operator do të mbulojë vetë kostot e tij financiare për adaptimin e rrjetit për të mundësuar bartjen e numrit dhe kostot për mirëmbajtjen e faciliteteve.

## Neni 22

### **Trajtimi i Ankesave dhe mosmarrëveshjeve dhe monitorimi i performancës së operatorëve për portimet<sup>31</sup>**

1. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindi ndërmjet operatorëve ose ndërmjet pajtimtarëve dhe operatorëve për çështje që lidhen me zbatimin e portabilitetit të numrit dhe rregullimeve të përcaktuara në këtë rregullore, tentohet të zgjidhet ndërmjet palëve në mirëkuptim. Në rast të kundërt, secila palë ka të drejtë të drejtohet AKEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në përputhje me përcaktimet ligjore përkatëse dhe procedurat që AKEP zbaton sipas akteve të miratuara dhe publikuara prej tij, Rregullore Nr. 18 datë 11.06.2010 dhe Rregullore Nr. 29, datë 29.05.2013.
2. **AKEP do të monitorojë çdo tre muaj nëpërmjet sistemit CRDB performancën e operatorëve për portimet si dhe do të kryejë inspektime në bazë të statistikave të ankesave të pajtimtarëve dhe CRDB, si dhe në raste individuale të problemeve me zbatimin e portabilitetit sipas përcaktimeve të ligjit 9918 dhe kësaj Rregulloreje.**
3. **AKEP bazuar në raportet e CRDB për performancën e operatorëve në lidhje me zbatimin e afateve dhe rregullave të portimit si dhe në ankesat dhe mosmarrëveshjet e pajtimtarëve për portimin e numrit (përfshirë statistikave për ankesat) merr masa proporcionale për operatorët që nuk zbatojnë portabilitetin e numrit ose që rezultojnë me shkelje të përcaktimeve të kësaj rregulloreje.**

## Neni 23<sup>32</sup>

### **Masat Administrative**

1. Kur një operator nuk zbaton portabilitetin e numrit për pajtimtarët e tij, sipas nenit 87 të ligjit 9918, i ndryshuar dhe kësaj rregulloreje dhe kjo nuk përbën kundërvajtje penale por administrative atëherë në zbatim të nenit 137 të ligjit 9918, i ndryshuar, dënohet me gjobe.  
**Mos-zbatim i portabilitetit sipas nenit 87 të Ligjit 9918 është rasti kur një operator rrjeti publik telefonik nuk ka kryer adaptimet e rrjetit për të mundësuar shërbimin e portabilitetit të numrit (port-out dhe/ose port-in) në rrjetin e tij sipas pikës 5 të nenit 21 të kësaj rregulloreje.**
2. Në rast të mos shlyerjes së detyrimeve financiare **të parashikuara në nenin 21 të kësaj Rregulloreje operatorit të rrjeteve/shërbimeve publike telefonike i ndërpritet aksesit në sistemin CRDB për portabilitetin e numrit dhe ndaj tij** aplikohet gjoja sipas parashikimit në paragrafin 1 të këtij neni.

### **Shfuqizime**

Rregullore Nr. 13 datë 16.04.2010 “Për Portabilitetin e Numrit”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP, Nr. 1219, datë 07.04.2010, e ndryshuar, shfuqizohet.

<sup>31</sup> Është ndryshuar titulli i nenit dhe janë shtuar paragrafët nr.2 dhe 3.

<sup>32</sup> Në këtë nen është shtuar paragrafi i dytë i pikës 1 dhe është ndryshuar pika 2, e cila aktualishtë:  
*Në rast të mos shlyerjes së detyrimeve financiare të parashikuara në këtë rregullore ndërpritet ofrimi i shërbimit të portabilitetit dhe aplikohet gjoja sipas parashikimit në paragrafin 1 të këtij neni.*

## **Neni 23**

### **Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit të saj, me vendim të Këshillit Drejtues të AKEP.

## **Neni 24**

### **Dispozita kalimtare**

Detyrimi për zbatimin e kësaj rregulloreje fillon 30 dite nga data e publikimit të saj.

## Aneks 1<sup>33</sup>

Formulari i deklarimit të të dhënave dhe dokumenteve të pajtimtarit që kërkon bartjen<sup>34</sup>

1	Numri i telefonit që do të bartet:
2	Emri i pajtimtarit:
3	Numri Personal (nëse pajtimtari është <b><u>i regjistruar te operatori Dhënës si individ</u></b> ):
4	Numri NIPT (nëse pajtimtari është i regjistruar <b><u>te operatori Dhënës si biznes</u></b> ):
5	Numri i telefonit do të bartet nga rrjeti i (“operatori Dhënës”):
6	Numri i telefonit do të bartet në rrjetin e (“operatori Marrës”):
7	<b><u>Data e Kërkesës: dd/mm/viti Ora: hh.mm</u></b>
8	<b><u>Data kur do të realizohet bartja/aktivizohet numri i bartur: brenda 24 orësh ose 1 (një) dite pune nga data/ora në pikën 7 ose më datë dd/mm/viti</u></b>

**Pajtimtari:**

**Emër Mbiemër, Nënshkrimi**

**Për operatorin:**

**Nënshkrimi, Vendi dhe Data**

<sup>33</sup> Në formularin e këtij Aneksi janë bërë saktësimet e nënvizuara duke shtuar dhe datën e kërkesës (fusha 7). Fusha 8 aktualisht është:

*Data kur do të bëhet bartja:*

*brenda 3 ditëve pune ose ---.---.---*

<sup>34</sup> Pajtimtari pajiset me një kopje të printuar ose elektronike të formularëve të plotësuar sipas Aneks 1 dhe 2 të kësaj Rregulloreje



**Formulari i deklaramit që pajtimtari duhet të nënshkruajë me operatorin Marrës**

Unë, i nënshkruari, jam informuar si më poshtë:

- a) Bartje e një numri të telefonit do të thotë që numri i plotë tranferohet nga rrjeti i një operatori (“operatori Dhënës”) në rrjetin e një operatori tjetër (“operatori Marrës”). Si pajtimtar i një shërbimi telefonik kam të drejtën të kërkoj bartjen dhe që të dy, operatori dhenes dhe marres janë të detyruar të mbështesin këtë proces. Pajtimtari kërkon bartjen nëpërmjet nënshkrimit të këtij dokumenti dhe paraqitjes së tij tek operatori Marrës, i cili duhet te ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të bartur numrin **dhe udhëheq procesin. Operatori Marrës do të më njoftojë për ecurinë e procesit të bartjes.**
- b) Kontrata ime ekzistuese me operatorin Dhënës do të përfundojë në kohën kur bartja bëhet efektive, por bartja nuk do të përfundojë detyrimet ekzistuese kontraktore.
- c) **kërkesa për bartje për një numër me paspagim mund të pranohet nga operatori Dhënës por nuk mund të miratohet (do jetë në status Pezull) deri në shlyerjen e detyrimeve të prapambetura që unë kam ndaj operatorit Dhënës sipas përcaktimeve të kontratës ekzistuese që unë kam me operatorin Dhënës.**
- d) Nëse kam ndonjë pyetje lidhur me shumën e detyrimeve të papaguara dhe ndonjë pagesë tjetër të mundshme ndaj operatorit Dhënës, këto çështje duhet ti sqaroj në kontakt të drejtpërdrejtë me operatorin Dhënës pas nënshkrimit të këtij dokumenti.
- e) Operatori Marrës është i detyruar të më informojë lidhur me detajet e kushteve të kontratës sime të re, në veçanti lidhur me çdo detyrim që unë duhet ti paguaj operatorit Marrës dhe nëse unë mund të përdor pajisjet ekzistuese në rrjetin e operatorit Marrës.
- f) Në kohën kur operatori marres dërgon kërkesën për bartjen e numrit në CRDB, nuk mund të kërkoj anulimin e procesit të bartjes së numrit.
- g) Nëse kam ndonjë pyetje tjetër lidhur me kushtet ose tarifat e kontratës së re, do ti sqaroj këto çështje në kontakt të drejtpërdrejtë me operatorin Marrës para nënshkrimit të këtij dokumenti.

Deklaroj si më poshtë:

1. Aktualisht përdor numrin e përmendur të telefonit në rrjetin e operatorit Dhënës dhe dëshiroj të nderpres kontaktën me operatorin Dhënës.
2. Dëshiroj të nënshkruaj kontratë me operatorin Marrës sipas termave dhe kushteve kontraktore, përfshirë tarifave të shërbimeve të cilat më janë paraqitur nga operatori Marrës në dokumente të veçanta.
3. Dëshiroj që të dy operatorët të bashkëpunojnë dhe të bartin numrin e përmendur nga rrjeti i operatorit Dhënës në rrjetin e operatorit Marrës në kohën e kërkuar. Autorizoj operatorin Marrës, që në emrin tim, të ri-drejtojë kërkesën time operatorit Dhënës për ndërprerjen e kontratës time ekzistuese.

***Pajtimtari:***

***Emër Mbiemër, Nënshkrimi***

***Vendi, Data, Ora***

<sup>35</sup> Në këtë aneks është bërë shtesa e pjesës së nënvizuar në pikën (a) dhe është ndryshuar pika (c) e cila aktualisht është:

*Unë duhet ti paguaj operatorit dhënës të gjitha detyrimet e papaguara që dalin nga kontrata ime ekzistuese perpara ekzekutimit te kerkeses per bartje*

**LISTA E RAPORTEVE STANDARDE NGA CRDB**

1) Raporte statistikore :

I. Raporte statistikore lidhur me:

a) Numrin total të kërkesave për bartje të dërguara tek DBQ të pranuar ose refuzuara (për çdo OM);

b) Numrin e kërkesave për bartje të anuluar (për çdo OM ose ODH) ;

c) Numrin e kërkesave për bartje të refuzuara nga OpDBQ ose ODH (për çdo OM);

d) Numrin e kërkesave të ndërprera (për çdo OM);

e) Numrin e kërkesave për numrin e bartur të shkëputura (për çdo OM);

f) Numrin e kërkesave për ndryshim të informacionit bazë (për çdo OM).

II. Raporte statistikore të përgjithshme lidhur me:

a) Numrin e numrave gjeografik të bartur (për çdo OM);

b) Numrin e numrave jo gjeografik të bartur, bashkë me ato për shërbimet telefonike të lëvizshme (për çdo OM);

c) Numrin e numrave jo gjeografik të bartur për shërbimet telefonike të lëvizshme (për çdo OM);

d) Numrin total të numrave që kanë marrë bartje (për çdo OM);

e) Numrin total të numrave të transferuar ndërmjet bartjes (për çdo ODH);

f) Numrat e shkëputur dhe transferuar tek ODHF-ja (për çdo OM).

2) Raporte të ecurisë së procesit të bartjes:

a) Raporte mbi afatet e tejkaluar (për çdo OM ose ODH) ;

b) Raporte mbi listën e mesazheve (që lejojnë monitorimin e historisë së levizjes, bazuar në listën e mesazheve të shkëmbyera gjatë procesit respektiv);

c) Raporte mbi kohën mesatare të procesimit në prezantimin e informacionit ndërmjet interfazave të ndryshme;

d) Raporte mbi parametrat e monitoruara të cilësë së procesit të bartjes.

3) Raporte mbi funksionimin e DBQ, lidhur me:

a) Kohën totale kur DBQ nuk funksiononte ;

b) Periudhat e skeduluara të ndërprerjeve gjatë vitit;

c) Periudhat jo te skeduluara të ndërprerjeve gjatë vitit;

d) Kohën mesatare për rifillimin e funksionimit të DBQ-së pas ndërprerjes së pa skedular ;

e) Zgjatjen totale kur DBQ nuk funksiononte, gjatë programit të punës së rregullt ;

f) Zgjatjen totale kur linket komunikuese nuk funksionin;

g) Ankimet e përdoruesve në lidhje me funksionimin e DBQ dhe mënyra për zgjidhjen e këtyre ankimeve.

4) Raporte në lidhje me dedektimin e përpjekjeve për akses të paautorizuar.

---

<sup>36</sup> Aneksi 3 është një aneks i ri i propozuar për tu përfshirë në rregullore dhe përmban raportet që mund të merren nga CRDB dhe tregues që AKEP mund të publikojë sipas përcaktimeve në shtesat e propozuara në këtë rregullore.